

## Procesverbal

*Nga Mbledhja VIII (e tetë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë:  
29.08.2024*

### *Rend Dite*

- 1) Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet VI dhe VII;
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën VIII; dhe
- 3) Eventuale.

**Arijeta Skeraj:** Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje anëtarë të KPF-së! Përshëndetje përfaqësues të OSBE-së! Mirë se keni ardhë në Mbledhjen VIII të rregullt për vitin 2024 të KPF-së! Materialin besoj që e keni pranuar të gjithë! I kemi tri pika të rendit të ditës. Nëse keni diçka rreth rendit të ditës, urdhëroni! Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë rendin e ditës. Vazhdojmë me pikën e parë: Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet VI dhe VI. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 7 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohen procesverbalet. Pika e dytë është shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën VIII. Pika e parë është miratimi i Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave. Kush do me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe 2 abstenim, e kalojmë këtë pikë. Pika e tretë është pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

**Artan Loshaj:** Mirëmëngjesi për të gjithë! Zonja kryesuese, të kam thënë deri në fund të mandatit mo nuk kam me folë, po në eventuale një pyetje direkte për ty edhe për kryetarin. Ndriçimi në fshatin Rrenc, është qe katër vite projekti. Keni premtue që do ta bëni. Unë sa erdha poshtë, u informova që hala as në tender nuk ka dalë. Unë e di që fshatin Rrenc e keni pak si pikë të zezë. Është mirë me kqyrë ti si kryesuese, si përfaqësuese e krejtve po sidomos e fshatit Rrenc, me kqyr ku është projekti, mos të na dështoje, sa është ma herët. Edhe një kubëzim dyvjeçar, 5 mijë plus 65 mijë euro, edhe ai s'po di a është, më thanë hala s'ka dalë. Për në Rrenc po më intereson, masi janë zgjedhjet ngat, nashta gabim më kanë thënë ata mu, veç... qato dritat a po i bojmë sivjet a jo?

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, Artan! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë pyetja ishte për mu dhe për kryetarin. Unë, sa për informatë, dje bile e ka takuar kryetarin për rastin e ndriçimit të fshatit Rrenc. Kryetari tha hala nuk e ka pru projektin, veç po presim me na pru projektin edhe me e qit në tender.

**Artan Loshaj:** Unë e kam thënë edhe pak më herët, projekti është i bërë gati qe katër vite. E ken ë zyrë të Bean Hadziasan. Katër vite, se e kemi bo në vitin 2020. Ai projekt ka kushtue 30 mijë euro, unë ju kam pyet juve qysh para katër viteve ka kushtue 30 mijë euro, tash me 20 mijë euro do ta kryni. Jau u kam bo këtë pyetje edhe ma herët. Projekti është i bërë gati, veç me nxjerr prej fiokave edhe me e qit në tender.

**Uran Halimi:** Përshëndetje, të nderuar të pranishëm! Nuk desha me e marrë fjalën, se zakonisht e lë për seanca të rregullta, po t'i bëj nja dy pyetje edhe unë. Due me u ndërlidhë me seancën e fundit që opozita ia mundësoi pozitës eliminimin e pikës eventuale, edhe pse kemi pas çka me diskutue. Pas saj, pasoi një zënkë me ish-drejtorin e Administratës, edhe e patëm një konflikt verbal, me arsyen që e kam akuzue edhe ju kam akuzue vazhdimisht për hajni. Më bëri shumë përshtypje ai neutraliteti i kryetarit, kur ai goxha e degradoi nivelin edhe përdori fjalë nga më të ulëtat edhe ma banalet në këtë Kuvend. Mirëpo, ishte pas mbylljes së seancës, znj.kryesuese. Tjetra, e takova kryetarin para disa ditëve, një traktor që e kanë ble me paret e performancës. Tha: Qe, po e blejmë traktorin, tin a ço në prokurori. Më mbeti pikë pa i thënë që unë në prokurori nuk e çoj kërkond edhe kurrë në jetë s'kisha dashtë me e çue dikënd në prokurori. Nuk të kisha votue për me të çue në prokurori, kryetar. E hiç për hiç me bo koalicion me ju. Thashë edhe atë ditë, traktora kemi pas, po rrugë s'janë çelë. Traktora na kemi pas, po u dashtë me iu grah dikush atyre traktorave edhe me punue dikush me ata traktora. Ajo që po më bën shumë përshtypje edhe po më jep shumë vullnet për me luftue vazhdimisht edhe me kundërshtue këtë pushtet, është që kohën e fundi ka nis edhe hakmarrja e këtij pushtetit ndaj familjarëve të mi. Konkretisht, shoqen time, arsimitare qe më shumë se 10 vite, mbi 12 vjet i ka përvojë pune, e kanë përgjysmue normën e saj. E kanë lënë vetëm me 12 orë, me atë arsye që s'paska orë. Kryetar, jeni t'u bo shumë mirë, sinqerisht. Me u kërcënue unë, e me u shantazhue në këtë mënyrë, kurrë në jetë s'munden me ndodhë kjo. Ishalla edhe dy orë i jesin, po unë me u ndalë, kryetar, as mendjen s'e kam. Ju qysh ia keni nis e qysh jeni mësue, para edhe mas luftës, e dini, mendoni me e vazhdue të njëjtën. Unë po ju them, veç vazhdone, kryetar. E ku do të mbërrijmë, kemi me e pa. Faleminderit shumë! Mungesa e normave – ka thënë

edhe ish-drejtori i DKA-së, zSelim Kryeziu, unë kam qenë këtu – mungesa e normave ekziston, bile-bile e ka përmend edhe numrin, që janë diku mbi 100 norma mangu. Nëse normat janë mangu, tepër janë mësuesat. Domethënë, 100 mësuesat janë pa norma të plotësime, pse bash shoqja jeme po u dukta me qenë e para prej këtyre 100-ve. Me e pas përzie kah mesi diku, 50-60, hiç s’u konë problem kryetar. Edhe krejt le t’ia hekin. Ama e para po u dukta m’u konë, a mendoni në këtë mënyrë me më ndalë mu a? Është shumë e ulët, ekstrem e ulët. Nëse na bëjmë politikë këtu, çka kanë faj familjarët tanë? Mu keni me më pas këtu, unë ju thashë edhe një seancë më herët, harrone që unë nështrohem. Ama mënyra të cilën po e përdorini është – për Zotin – shumë e ulët.

**Bexhet Xheladini:** E nderuar kryesuese, të nderuar anëtarë të KPF-së! I nderuar përfaqësues i OSBE-së! Ju përhëndes të gjithëve! Sa i përket pyetjes së asambleistit të PDK-së, Artan Loshajt, për projektet e fshatit Rrenc, kubëzimi ka dalë dhe kontrata është nënshkruar, Ndërsa, sa i përket projektit të ndriçimit, besoj që brenda javës del tenderi. Kemi pas probleme pak me hartuesin e projekteve dhe vazhdojmë të kemi probleme me të. Ndërsa, sa i përket pyetjeve të Uranit dhe shqetësimeve që i ngriti, sa i përket normës së bashkëshortes tuaj, atë nesër ia bëni pyetje drejtorit të Arsimit. Kryetari me norma nuk merret. Dhe, e ke shumë gabim që nëse mendon se është hakmarrje. Unë nuk e di çka është problemi me normën, po nesër drejtori i Arsimit ta jep përgjigjen, nëse është e vërtetë ose s’është e vërtetë. Edhe nëse është ashtu qysh po thuesh, pse është ashtu. Ndërsa, sa i përket shqetësimeve tjera, prokurorisë e gjërave tjera, ato janë çështje që unë gjithmonë kam thënë, edhe po them, kush mendon që këtu bëhet padrejtësi, mundet lirisht me shkue te organet e drejtësisë dhe në prokurori. Ajo është e drejtë e çdokujt, e çdo qytetari, atë nuk mund me ta ndalue kërkush. Nesër, në mbledhjen e seancës, unë i kam edhe disa shqetësime tjera, po nesër do të përgjigjem për atë. Edhe disa video që i keni bërë në rrjetet sociale, edhe reagimin që e ka bërë Filiz Mustafa. Po atë nesër, në mbledhjen e Asamblesë, para mediave do ta them atë. Gjithashtu, edhe disa fjalë do t’i them që ti kishe fillue me u marrë me biografinë time, që je duke punuar, që të kaluarën time je duke e studiue. Edhe atë nesër do ta shohim. Faleminderit!

**Uran Halimi:** Sa i përket personaleve, vazhdimisht keni tentue, duke u nis prej juve z.kryetar, e te ish-drejtori yt, te biografia, bile ai e zgjeroi, e dish shumë mirë, po e dish ti për çka e pat fjalën ai, jemi tha familje e bajraktarëve, e jo e çobejve. Atë ditë, mas seancës. Edhe ti me mu e ke pas personale vazhdimisht. Po qysh doni, e vazhdojmë, qysh e keni nis, çone deri në fund, se unë këtu jam, kryetar. Te norma, deshta me të kallxue që shoqja jeme është marrë në punë me vendim edhe

me konkurs për 20 orë në ciklin e ulët, e në ciklin e ulët janë mbi 20 orë. Ligjërisht edhe kam me ju ndjek, me izëm të Zotit. E, sa u përket tjera sendeve, na për qat punë jemi këtu, kryetar. Edhe para mediave, se na zakonisht e bëjmë para mediave. Po ti po duesh me dalë edhe në personale, nesër diskutojmë edhe për personalet. Hiç nuk e kam këtë problem. Na kur reagojmë, e bëjmë mediatike edhe shumë ashiqare. E për tjerat sende, i qesim këtu në Kuvend, nëse je i gatshëm, unë hiç s'e kam atë problem, i nderum kryetar.

**Arijeta Skeraj:** Faleminderit, Uran! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë shihemi nesër në seancë!